

Ti konsiderohesh fëmijë nëse je nën moshën 18 vjeç



FËMIJË MIGRANTË TË PASHOQËRUAR NË FRANCË

CILAT JANË TË DREJTAT E TUA?

A semi-circular graphic with a dashed white border. Inside, four hands of different colors (light green, yellow, orange, and light orange) are reaching out towards the center. The text "DISA KËSHILLA DHE KONTAKTE TË DOBISHME PËR TË TË NDIHMUAR" is written in red, bold, sans-serif font in the center of the hands.

DISA
KËSHILLA DHE
KONTAKTE TË
DOBISHME PËR TË
TË NDIHMUAR



Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian



Roli që kanë profesionistët: punonjësit e policisë, avokatët, kujdestarët, edukatorët, gjykatësit, mjekët etj. **është për të të mbrojtur ty**

Tregojua historinë tënde këtyre profesionistëve që të të ndihmojnë

Ti ke të drejtë të marrësh asistencë për ushqim, strehim, shkollim, shëndetësi... dhe **çdo gjë është falas** për fëmijët!

Mos ngurro të bësh pyetje për gjëra që nuk i kupton apo nëse nuk pajtohesh



Nëse nuk je i shoqëruar nga prindërit ose nga një pjesëtar i familjes në Francë, gjykatësi mund të caktojë një kujdestar ose një administrator të posaçëm për të të mbështetur gjatë proceseve dhe seancave ligjore. Këta janë njerëz të besuar që do të veprojnë sikurse një prind. Ata gjenden këtu për të të **ndihmuar që të të respektohen të drejtat e tua.**



Në varësi të situatës, do të të caktohet një **kujdestar** që do të jetë me ty deri kur të mbushësh 18 vjeç, ose një **administrator i posaçëm** që do të të gjendet për një kohë më të shkurtër, sa të zgjasë një procedurë si **kërkesa për azil.**





Policia

17

ose **112**

(telefonatë falas)

Policia është këtu për të ndihmuar nëse je viktimë e dhunës ose je detyruar të bësh diçka që nuk do dhe që është e dëmshme për ty. Është me rëndësi të dish që ti nuk duhet të ndëshkohesh për diçka që ke qenë i detyruar të bësh, edhe nëse është e gabuar apo e paligjshme.

Nëse merresh në pyetje nga policia, **ti ke të drejtën:** të shoqërohesh nga një i rritur i besuar, një shoqatë, avokat dhe të kesh në dispozicion një përkthyes falas. **Mos ngurro të kërkes për cilëndo nga këto!**

➤ Në Francë, është shpesh e vështirë të njihesh si i mitur i huaj i izoluar. Kur ndodh kjo, është **ASE-ja (shërbimi për mirëqenien e fëmijëve)** ajo që mban përgjegjësi për të të përkrahur me ushqim, strehim, shkollim...

➤ Në çdo kohë, **mund të të vij në ndihmë shoqata** që të përkrahesh nga ASE-ja dhe të përfitosh nga asistencë falas.

➤ Brenda këtyre strukturave, mundesh për shembull të: **takosh** fëmijë të tjerë, **luash** dhe bësh qejf, **bisedosh** me të rritur të besuar, **vizitohesh nga mjekë** (psikologë, gjinekologë, dentistë...) ose **mësosh** frëngjisht.

Ç'ËSHTË TRAFIKIMI NJERËZOR?

Ti ose një nga shokët e tu mund të jeni viktimë e trafikimit pa e kuptuar.

A ke qenë në një situatë ku të është dashur të:

- **bësh seks** apo **kryesh uepra seksuale**?
- **punosh**(për shembull, në shtëpinë e dikujt duke kryer punë shtëpiake apo kujdesur për fëmijë, në fabrikë apo në restorant)?
- **lypësh, vjedhësh ose kryesh krime**?
- **rritësh, mbash ose shesësh drogë**?
- **heqësh organet e tua për t'i shitur**?
- shlyesh një '**borxh**' duke punuar apo dhënë ndonjë shërbim tjetër?

A ke qenë ti/familja jote nën kërcënim?

Nëse i përgjigjesh "po" njërës prej këtyre pyetjeve, ti ose shoku yt mund të jeni viktimë trafikimi. Bisedo me një profesionist të cilit i beson nëse je i shqetësuar, që të ndihmojë me ndaljen e abuzimit dhe me mbrojtjen e të rinjve të tjerë.

TRAFIKIMI
NJERËZOR ËSHTË
KRIM SERIOZ DHE
ABUZIM I TË DREJTAVE
TË TUA

LISTA E SHOQATAVE
ANTARE TË
PËRBASHKIMIT "SË
BASHKU KUNDRA
TRAFIKIMIT TË
QENIEVE NJERËZORE":

<http://contrelatraite.org/>





NË FRANCË MUND TË PËRFITOSH KËSHILLIM LIGJOR FALAS NË SAJË TË NJË AVOKATI APO SHOQATAVE.

Një numër qytetesh në Francë ofrojnë **dhomën e komitetit të avokatëve për të mitur.**

Gjenden gjithashtu **pika shërbimesh ligjore** dhe **gjykata** kudo në Francë:

www.annuaires.justice.gouv.fr

VLERËSIMI I MOSHËS

Nëse nuk ke dokumente për të vërtetuar moshën ose nëse disa të rritur kanë dyshime për dokumentet e tua, ata mund të kërkojnë të të kontrollojnë moshën:

Duke të të kontrolluar dokumentet

Duke organizuar një intervistë me një profesionist (pyetje mbi shkollën, gjendjen tënde familjare etj.)

Duke kryer një analizë kockore (një radiografi ose ekzaminim të dhëmbëve)

MOS NGURRO TË KONTAKTOSH NJË AVOKAT!

Shembull:

në Paris

Palais de justice

10 bd du Palais

01.42.36.34.87

në Lion

42 rue de Bonnel

04.72.60.60.00

PRA INFORMOHU!

MBI PROCESET GJYQËSORE

Ke gjithnjë të drejtën të pranosh ose refuzosh t'i nënshtrohesh këtij ekzaminimi. Megjithatë, është më e kujdesshme të jesh pranë profesionistësh të besuar që ata të të ndihmojnë të bësh zgjedhje lidhur me situatën tënde.





Mos ngurro
të pyesësh
profesionistët rreth teje
se ku mund të marrësh
asistencë mjekësore dhe
psikologjike falas.

- Në Francë, **nëse je nën 18 vjeç**, mund të qëndrosh brenda territorit dhe të përfitosh nga shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve **edhe pa patur dokumente zyrtare** si pasaportë apo certifikatë lindjeje. Pyet profesionistët për këshilla që të marrësh një lejeqëndrim (për shembull, nëse ke dëshirë të punosh nga mosha 16 vjeç apo nëse po i afroresh moshës madhore).



- Së fundi, duhet të dish se nëse përballesh me rrezik persekutimi në vendin e prejardhjes, **ke të drejtën të paraqesësh kërkesë për azil**. Kjo është e mundur pavarësisht se ç'moshë ke, por duhet ta bësh sa më shpejt. Një administrator i posaçëm ose kujdestar do të caktohet për të qenë me ty gjatë këtij procesi.

Në Francë,
shkollimi është falas
dhe i detyrueshëm
deri në moshën 16 vjeç.
Nganjëherë, gjetja e një
vendi shkolle mund të
marrë kohë, por mos hiq
dorë!



CIMADE

është një shoqatë që u vjen
në ndihmë të huajve. Ajo
është e pranishme në disa
qyte të Francës.

www.lacimade.org/



OFPRA (Office français de protection des réfugiés et apatrides)

do të shqyrtojë kërkesën tënde për
azil pasi t'ia kesh treguar historinë një
punonjësi.

www.ofpra.gouv.fr/

9h-15h
201 rue Carnot,
94136

Fontenay-sous-bois Cedex

01.58.68.10.10

Gjithashtu mund t'i referohesh këtij
dokumenti për të marrë vesh se çfarë
do të ndodhë:

[https://ofpra.gouv.fr/sites/
default/files/atoms/files/
ofpra_guide_de_lasile_mie
en_france.pdf](https://ofpra.gouv.fr/sites/default/files/atoms/files/ofpra_guide_de_lasile_mie_en_france.pdf)





MBROJTËSI I TË DREJTAVE

Mund t'i drejtohesh kur të drejtat e fëmijëve nuk respektohen.

Mund t'i drejtohet fëmija vetë drejtpërdrejt, falas.

09.69.39.00.00

(fatura e një telefonate lokale)


www.defenseurdesdroits.fr/fr/saisir-le-defenseur-des-droits

UDHËZUESI I GJYKATAVE PËR FËMIJË

sepse mund t'i shkruash drejtpërdrejt një gjykatësi për fëmijë që të të mbrojë:

www.annuaires.justice.gouv.fr/annuaires-12162/annuaire-des-points-dacces-au-droit-21772.html#cmq_path=liste&cmq_page=4







Prodhuar në bashkëpunim me



Fonds de dotation

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajta e këtij botimi është përgjegjësi ekskluzive e ECPAT Francë dhe partnerëve të tij në projektin ReACT: ECPAT Belgjikë, ECPAT Gjermani, ECPAT Holandë dhe ECPAT MB dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

